



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: [rmuca@klsb.org.al](mailto:rmuca@klsb.org.al); Web-site: [www.klsb.org.al](http://www.klsb.org.al)

### Auditim performance: "CENSUS 2011"

#### Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas shkresës nr. 1227 njoftim për fillim auditimi, ndërmori auditimin me temë "CENSUS-i 2011". Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Institutin e Statistikave (INSTAT), pasi ky është institucioni që ka përgjegjësi direkte në ofrimin e këtij shërbimi. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve dhe palëve të interesit. Raporti përfundimtar është hartuar pasi janë shqyrtuar observacionet dhe shpjegimet e dërguara nga INSTAT, si edhe pas konsultimeve me palët e interesit.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt-Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamenti i Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe e Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të Ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997, "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet e bëra me Ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000,

### KONKLUDOI:

Censusi i Popullsisë dhe i Banesave është procesi i numërimit të plotë të të gjithë individëve, njësive ekonomike familjare dhe banesave. Ai ka një rëndësi të veçantë sociale dhe ekonomike. Censusi bën një fotografi të momentit mbi gjendjen sociale dhe nivelin e jetesës së popullsisë në një çast të përzgjedhur. Vetëm Censusi mund të gjenerojë të dhëna kaq të plota dhe të detajuara. Rezultatet e tij janë vitale për vendim-marrjen politike, ekonomike e sociale.

Objektivi kryesor i Censurit është të japë një kuadër të përditësuar të realitetit shoqëror dhe demografik të vendit, sa më afër standarteve raportuese europiane. T'i ofrojë qeverisë të dhëna statistikore të përshtatshme për qeverisjen kombëtare dhe monitorimin e reformave. Rezultatet e Censurit shërbejnë si guidë orientuese në planet strategjike të zhvillimit dhe ofrojnë një panoramë aktuale dhe të saktë të realitetit demografik, ekonomik dhe social në vend, të cilat janë jetësore për politikën dhe marrjen e masave efektive. Rezultatet statistikore të Censurit janë një pasuri e përbashkët e të gjithë shoqërisë shqiptare. Informacioni që merret nga statistikat e Censurit nuk mundësohet nga asnjë burim tjetër. Një nga qëllimet e Censurit është edhe bërja e prognozave të sakta për popullsinë sipas grup-moshave me synim zhvillimin e ardhshëm të shoqërisë.

Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011 është Censusi i 11-të i kryer në historinë e Shqipërisë. Censusi i Popullsisë dhe Banesave është kryer për herë të parë në Shqipëri në vitin 1923. Ky proces kryhet një herë në 10 vjet për të matur statistikisht realitetin demografik, ekonomik dhe

social në vend. Regjistrimi i fundit i Përgjithshëm i Popullsisë dhe Banesave është kryer në vitin 2001. Frekuenca e regjistrimit të popullsisë një herë në 10 vjet është një standart europian për të lejuar krahasueshmërinë e të dhënave të të gjitha shteteve europiane dhe Censusi kryhet pothuajse në një njëjtën periudhë për të gjitha vendet e Europës.

Censusi mbulon të gjitha zonat urbane dhe rurale të territorit të RSH. Ai përfshin popullsinë banuese, si dhe të gjitha objektet brenda territorit të Republikës, që përdoren për banim, pavarësisht nëse ato janë pronë e luajtshme ose e paluajtshme. INSTAT ka kryer Censusin e fundit të Popullsisë dhe Banesave në 1 Tetor 2011, ku janë regjistruar:

- Njësitë ekonomike familjare;
- Individët;
- Bashkëjetesat kolektive;
- Banesat rezidenciale (të banuara ose jo) dhe tipe të tjera banesash;
- Të huajt (prezentë në momentin e Censurit).

Ky auditim shërben për të informuar palët e interesuara mbi zhvillimin e këtij procesi, përgatitja dhe kryerja e të cilit kërkoi angazhimin e një vëllimi të madh burimesh financiare, njerëzore dhe materiale i realizuar me fonde të Qeverisë Shqiptare, Komisionit Europian të donatorëve si Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA) dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Me këtë auditim të performancës jemi përpjekur të vlerësojmë nëse janë arritur objektivat e Census 2011 për regjistrimin e popullsisë dhe të banesave, shkallën në të cilën janë përmbushur objektivat e programit dhe nëse kjo është arritur optimalisht, me synim identifikimin e problemeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e zhvillimit të proceseve të ardhshme.

Për sa më lart, Kryetari

## V E N D O S I:

**I.** Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit “CENSUS 2001” të ushtruar në Institutin e Statistikave.

**II.** Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të sugjerojë marrjen e masave për sa vijon:

***Pavarësisht punës së mirë në realizimin e objektivave kryesore dhe vështirësive të hasura nisur nga kompleksiteti i procesit të Census 2011, regjistrimi i popullsisë dhe i banesave nuk ka mbuluar të gjithë zonën e regjistrimit të RSH, si dhe nuk ka qenë i orientuar në përjasjen kosto-efektivitet.***

### Masa Organizative

#### 1. Konkluzion & Rekomandim

Ndryshimet e shpeshta në strukturën e Census dhe mungesa e një rregulloreje me detyra të mirë-përcaktuara, kanë sjellë ulje të shkallës së përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave të personave pjesëmarrës në Census.

Komunikimi verbal ndërmjet njërive të angazhuara në Census ka sjellë mos-dokumentimin e problematikave të shfaqura gjatë procesit, me qëllim përmirësimin e tyre në të ardhmen.

INSTAT, në kuadër të zhvillimeve të sistemeve të informacionit nga Ministrinë e Linjës, apo institucione të ndryshme, duhet të fillojë të krijojë një regjistër popullsie të përditësuar me të dhënat administrative dhe nga anketat. Ky regjistër do të mundësonte realizimin e Censurit

të popullsisë dhe banesave në vitin 2021 bazuar kryesisht në regjistra, duke shmangur mënyrën tradicionale.

**Menjëherë**

## **2. Konkluzion & Rekomandim**

Ndryshimi i vazhdueshëm i strukturës së Census, ka sjellë moskryerjen në kohë të detyrave për Njësitë e Censurit, që kanë sjellë ndryshime në përcaktimin e numrit të zonave të Census dhe si rrjedhojë edhe të stafit të jashtëm të rekrutuar të Census.

Përdorimi i dy standarteve në lidhjen e kontratave për anketuesit, kontrata këto me kushte të ndryshme, megjithëse pozicioni i punës ka qenë i njëjtë, ka çuar në diferencim të këtij personeli.

Mungesa e evidencave të sakta nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Census në lidhje me numrin e stafit të kontraktuar dhe mosprotokollimi i kontratave të lidhura, si edhe bashkëpunimi jo në nivelet e kërkuara me Sektorin e Financës, ka sjellë mospërputhje të numrit të stafit të rekrutuar nga ai i paguar.

Mosplanifikimi i saktë i buxhetit dhe mungesa e koordinimit të njësive mes tyre kanë sjellë vonesa në pagesën e një pjese të anketuesve.

Në të ardhmen të merret në konsideratë që të ngrihen struktura mbështetëse për organizimin e punës për realizimin e projekteve të planifikuara në programe, që të minimizohen lëvizjet e punonjësve pjesë përbërëse e këtyre strukturave.

Në formulimin e kontratave me punonjësit e rekrutuar, të specifikohen qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve, aplikimi i masave shtrënguese disiplinore dhe administrative, duke i përdorur si një instrument ndërgjegjësues për integritetin dhe profesionalizmin e punonjësve të përfshirë në Census.

**Në vijimësi**

## **3. Gjetje & Konkluzion**

Procesi i trajnimit të stafit të jashtëm të rekrutuar në Census është realizuar në një kohë shumë të shkurtër. Testimi për njohuritë e përfituara nuk ka qenë në nivelin e duhur, pasi ishte me pyetje shumë të thjeshta dhe nuk përcaktonin nëse anketuesit ishin familjarizuar me të gjitha pyetjet e pyetësorit.

Procesi i trajnimit të stafit të jashtëm të rekrutuar në Census, i cili konsiderohet i realizuar me sukses duke patur parasysh madhësinë e këtij procesi, është realizuar në një kohë shumë të shkurtër e të pamjaftueshme për përvetësimin e të gjitha pyetjeve të pyetësorit nga stafi i jashtëm i rekrutuar për Census.

**Të mbahet në konsideratë**

## **4. Konkluzion & Rekomandim**

Raportimi në hierarki anketues-kontrollor-mbikëqyrës-stafi i INSTAT, si edhe raportimi i njësive të Censurit tek Menaxheri i Census dhe Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, si dhe problematika e shfaqur gjatë procesit nuk është e dokumentuar, e cila do të ndihmonte në përmirësimin situatës gjatë procesit, si dhe në nxjerrjen e detyrave për procese të tjera regjistrimi.

Të përcaktohen dhe implementohen procedura të qarta dokumentuese të problematikave të ndeshura, për të adresuar siç duhet zgjidhjet e tyre në të ardhmen. Ky dokumentim do t'i shërbejë edhe uniformizimit të praktikave të ndërmarra për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara.

**Në vijimësi**

## 5. **Konkluzion & Rekomandim**

Mungesa e një analize paraprake të detajuar për të gjitha aktivitetet e procesit të Census, që në fazën e planifikimit për përcaktimin e kostos dhe burimet e financimit, ka çuar në rritjen e kostos totale të këtij procesi.

Për realizimin e procesit nuk është mbajtur parasysh marrëdhënia kosto-përfitim, për të maksimizuar përdorimin e burimeve në dispozicion.

Mosrakordimi mes Njesisë së Burimeve Njerëzore të Census dhe Sektorit të Financave ka sjellë pagesa të stafit të rekrutuar të Census mbi periudhën e përcaktuar në kontratë, si dhe pagesa të stafit mbi numrin e përcaktuar dhe të miratuar në Strukturën e Census.

Nga INSTAT, që në fazën e planifikimit, të bëhet një përlllogaritje e saktë e proceseve të punës për përcaktimin e kostos së projektit dhe burimin e financimit.

**Në vijimësi**

## 6. **Rekomandim**

Nga INSTAT, me përfundimin e procesit të CENSUS-it, të bëhet llogaritja e plotë e vlerës totale të realizimit të projektit dhe të auditohet nga Auditë i Brendshëm i INSTAT në lidhje me mirë-administrimin e fondeve buxhetore.

**Menjëherë**

## 7. **Konkluzion & Rekomandim**

Censusi nuk e ka përmbushur misionin e tij për pasqyrimin e nivelit të punësimit në vend, duke e bërë jo efektiv modulën përkatës të përfshirë në pyetësor.

Përfshirja e pyetjes mbi arsimimin në sektorin publik apo atë privat, duke e ndërlidhur me pyetjet mbi punësimin dhe elementë të tij, do të jepte një pasqyrim real të përqindjes respektive të punësuarve të arsimuar në sektorin publik dhe në atë privat.

Bashkëpunimi me palët e interesit do të sillte një programim më të mirë të punës në terren, duke u bazuar në të dhënat e tyre statistikore mbi shpërndarjen, vendbanimet e shtetasve të huaj në vend, kombësisë së tyre dhe pakicave kombëtare.

Mungesa e anketuesve të çertifikuar për njohuritë e tyre në gjuhën angleze çënon vërtetësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të pasqyruara prej tyre.

Në rastet e kontaktit me shtetas të huaj, kërkesa për asistim nga një tjetër anketues duke kontaktuar kontrollorin ka qenë demotivuese, duke patur në disfavor faktorin kohë.

Plotësimi i pyetësorëve të Census të mundësohet edhe në faqet online të INSTAT (shqip dhe anglisht); kjo për të patur një mbulim sa më të madh të popullsisë, si dhe për t'i ardhur më pranë asaj kategorie që për shkaqe të ndryshme nuk mund të jetë prezent në banesë gjatë orarit zyrtar, (kur edhe bëhet numërimi).

## 8. **Rekomandim**

Për çështje me ndjeshmëri publike, sikurse është feja, regjistrimi i informacionit të bëhet rigorozisht. Kjo duke marrë shkas edhe nga pakënaqësitë apo kontestimet që mund të bëjnë me të drejtë komunitetet fetare.

**Në vijimësi**

## 9. **Konkluzion & Rekomandim**

Për një numërim sa më gjithëpërfshirës të popullsisë dhe banesave, një spot televiziv apo informacion i shkurtër grafik, i transmetuar në javën e parafundit të Censurit, do të

ndihmonte në njoftimin e publikut në lidhje me ekzistencën e numrit jeshil pa pagesë për të reklamuar mos numërimin e tyre dhe reduktimin e numrit të personave të panumëruar.

Meqënëse fushata publicitare nëpërmjet radios kishte për qëllim informimin e çdo shqiptari apo të huaji rezident në Shqipëri, radiot e përzgjedhura duhet të kishin mbulim territorial me sinjal në të gjithë Shqipërinë dhe të liçensuara si të tilla nga entet kompetente të liçensimit. Gjatë kohës së zhvillimit të Censurit, në Shqipëri kanë qenë tre radio kombëtare të liçensuara: Radio Tirana, Top Albania Radio dhe Radio +2. Nëse numri i radiove do të reduktohej në 3 të tilla atëherë do të kishim afërsisht një përgjysmim të kostos referuar asaj reale.

Targetimi i të rinjve mund të kryhej edhe nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale, të cilat kanë një kosto ndjeshëm më të ulët krahasuar me radiot.

Për mbajtjen e kostove të ulëta, pa cënuar efektivitetin e këtij publiciteti, mund të përzgjidheshin vetëm 3 gazetatat me tirazhin më të madh, si edhe faqet e tyre informuese online, të cilat vitet e fundit vizitohen gjithmonë e më shpesh nga një pjesë e mirë e popullsisë. Nëse në anketën para-Census do të përfshihej edhe një pyetje se cila është media më e ndjekur, TV, radio apo gazetë, atëherë do të kishim një përdorim më eficient dhe efektiv të burimeve të kësaj fushate publicitare, dhe në të njëjtën kohë mbajtjen e kostove të ulëta.

Nga INSTAT në të ardhmen, për një fushatë publicitare sa më eficiente dhe ekonomike, të përdoren edhe rrjetet sociale të cilat janë me një kosto më të ulët.

INSTAT të përdorë si kanal komunikimi telefoninë celulare, duke dërguar mesazhe sensibilizuese për të arritur “audiencën maksimale”.

INSTAT-i të shfrytëzojë “zonat e nxehta të informacionit”, sikurse janë shkollat, universitetet, etj., për të sensibilizuar fëmijët e studentët. Në këtë mënyrë, sensibilizimi i shërben edhe krijimit të një tradite apo kulture regjistrimi tek brezi i ri.

**Në vijimësi**

#### **10. Konkluzion & Rekomandim**

Bashkëpunimi mes organeve të ngarkuara për të bërë Censurin ka qenë në nivele të mira, megjithëse ky bashkëpunim nuk është i dokumentuar.

Mos dokumentimi i bashkëpunimit dhe raportimit për ecurinë e procesit ndërmjet organeve të ngarkuara me ligj për të bërë Census: INSTAT, Komisioni Qendror i Censurit, Zyrat e Censurit në bashki e komuna, Komisionet e Censurit në qarqe, ka sjellë mos evidentimin e probleme të hasura gjatë zbatimit të procesit, me qëllim përmirësimin e tyre në proceset e ardhshme.

Të përcaktohen dhe implementohen procedura të qarta dokumentuese të problematikave të ndeshura, për të adresuar siç duhet zgjidhjet e tyre në të ardhmen. Ky dokumentim do t'i shërbejë edhe uniformizimit të praktikave të ndërmarra për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara.

**Në vijimësi**

#### **11. Konkluzion & Rekomandim**

Mos dokumentimi i monitorimit të progresit të aktiviteteve mbi bazën e planeve të hartuara për të gjithë komponentët e këtij procesi për respektimin e afatit dhe cilësisë që kërkohet, ka sjellë mos evidentimin e problemeve, korrigjimin e tyre në kohë dhe për nxjerrjen e detyrave për proceset e ardhshme.

Mos raportimi në Komisionin Qendror të Census i rasteve të refuzimeve për t'u regjistruar, mos trajtimi nga INSTAT në asnjë rast si kundërvajtje administrative dhe mos aplikimi i gjobave të parashikuara në ligjin për “Censurin e Përgjithshëm të Popullsisë dhe të Banesave Sociale”, kanë sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Të përcaktohen dhe implementohen procedura të qarta dokumentuese të problematikave të ndeshura, për të adresuar siç duhet zgjidhjet e tyre në të ardhmen. Ky dokumentim do t'i shërbejë edhe uniformizimit të praktikave të ndërmarra për të korrigjuar parregullsitë e konstatuara.

Të nxirren përgjegjësitë për masat e munguara administrative dhe të trajtohen ato konform ligjeve në fuqi.

**Menjëherë**

## 12. Gjetje & Konkluzion

KQR nuk është mbledhur sipas rregullores së miratuar (të paktën një herë në muaj). Mungojnë njoftimet e bëra nga Sekretariati për anëtarët e KQR, i cili duhet të përmbajë kohën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, si dhe materialet që do të shqyrtohen. Mungon gjithashtu protokollin i mbledhjeve dhe korrespondencat e mbajtura nga sekretariati i KQR. Një regjistër popullsie i përditësuar me të dhënat administrative dhe nga anketat e mëparshme, do të mundësonte realizimin e Censurit të popullsisë dhe banesave bazuar kryesisht në databazë, duke ulur koston dhe rritur cilësinë dhe saktësinë e të dhënave. Në këtë mënyrë mund të bëhet kryqëzimi i të dhënave.

**Të mbahet në konsideratë**

## 13. Gjetje & Konkluzion

Pyetëtori për këtë anketë është hartuar nga INSTAT në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë, por nuk është i dokumentuar miratimi i tij.

Anketuesit ishin planifikuar të përzgjidheshin të ndryshëm nga ata të Censurit (në respekt të parimit të pavarësisë statistikore të dy proceseve), por një numër mjaft i vogël anketuesish pjesëmarrës në Census janë angazhuar edhe në këtë anketë duke u caktuar në zona të ndryshme nga ato të Censurit.

Anketa pas Census ka pasur një përgatitje të mirë dhe përgjithësisht është realizuar në mënyrë efektive dhe efikase. Anketa është menaxhuar mirë në terren me vëmendje të veçantë kushtuar detajeve të operacionit nga personeli i INSTAT dhe mbikëqyrësit. Kjo anketë u krye duke zbatuar standardet ndërkombëtare dhe masa e mosnumërimit të popullsisë është e pranueshme dhe përqindja e mosmbulimit është brenda kufijve të arritura dhe nga vende të zhvilluara.

**Të mbahet në konsideratë**

---

### Grupi i auditimit

Rinald Muça  
Albana Agolli  
Dorino Meçe  
Alkida Llakaj

### Drejtori

Rinald Muça

Tiranë, Dhjetor 2013

